

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE 2025

Nr. Rendor	Data e kërkesës	Objekti i kërkesës	Data e përgjigjes	Përgjigja	Mënyra e përfundimit të kërkesës	Tarifa
Janar 2025-Nuk ka kërkesa per informacion						
1.	28.02.2025	Kerkese nga email/qytetar Të nderuar, Unë, xxxx, ju drejtohem me kërkesën për informacion lidhur me një lajm të fundit që ka qarkulluar në portalet online, veçanërisht në xxxxx. Në këtë artikull, përmendet një kallëzim penal i mundshëm nga ana juaj, ndaj meje, por unë nuk kam marrë asnjë njoftim në lidhje me këtë çështje. Duke qenë se ky informacion është i paprovuar dhe mund të ndikojë në integritetin	03.03.2025	Jemi njohur me emailin Tuaj. Vëmë në dijeni, se bazuar në nenin 21 pika 2 dhe neni 22 shkronja (a) dhe (e) të Ligjit nr. 9917/2018 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit” (i ndryshuar), Agjencia e Inteligjencës Financiare (AIF) shkëmben informacion për çështjet e pastrimit të produkteve të veprës penale, veprat penale ose veprimtaritë kriminale që gjenerojnë produkte të veprës penale apo financimit të terrorizmit me institucionet e sistemit të drejtësisë penale, dhe autoritetet e tjera kompetente të zbatimit të ligjit apo të inteligjencës. AIF nuk është organ i zbatimit të ligjit, por njësi inteligjence, si dhe nuk bën kallëzime penale. Gjithashtu, bazuar në nenin 22/1 të ligjit 9917/2008, i ndryshuar, çdo informacion apo e dhënë, e dërguar nga AIF për organet e zbatimit të ligjit, i nënshtrohet ligjit për informacionin e klasifikuar sekret shtetëror, për rrjedhojë njohja me këto informacione kryhet vetëm në përputhje me legjislacionin e fushës. Për sa më sipër, bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, nuk mund të japim më shumë informacion.	Përfunduar/ dërguar përgjigje me email	Jo.

		tim personal dhe profesional, ju kërkoj të më jepni informacion lidhur me: - Nëse është e vertete që është iniciuar një kallëzim penal nga Drejtoria juaj ndaj meje. - Nëse ky kallëzim është i vërtetë, pse nuk jam njoftuar për hetimin e nisur. Kërkoj gjithashtu që, nëse ky lajm është i pasaktë, të merren masat për të sqaruar publikisht këtë situatë dhe për të mbrojtur imazhin tim, si dhe atë të Kompanisë time.				
2.	11.03.2025	Kerkese per informacion me shkrese/subjekt Në mbështetje të Nenit 6 pika ç), nenit 8 pika b) të VKM nr.13 datë 11.1.2024 “Për përcaktimin e e procedurave të konstatimit, të	21.03.2025	Në AIF, është administruar shkresa Juaj, me anë të së cilës në bazë të ligjit ligji nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit” dhe nenit 8 pika b) të VKM nr.13 datë 11.1.2024 “Për përcaktimin e e procedurave të konstatimit, të shqyrtimit, të propozimit dhe të vendosjes së masave administrative nga AIF”, parashtroni kërkesën për informacion në lidhje me identifikimin e grupit të personave që kanë inspektuar veprimtarinë Tuaj . për sa më lart ju informojmë se personat përgjegjës për realizimin e Inspektimit ne distancë në subjektin tuaj janë Z. X.	Përfunduar/ dërguar përgjigje me shkresë	Jo.

		shqyrtimit, të propozimit dhe të vendosjes së masave administrative nga AIF' dhe dispozitave që parashikon ligji nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit" kërkoj të më informoni në lidhje me identifikimin e grupit të personave që kanë inspektuar veprimtarinë time.				
3.	17.03.2025	Kerkese per informacion me email/organizatë - A ka marrë institucioni juaj Raporte të Aktivitetit të Dyshimtë(RAD)/Raporte të transaksioneve të dyshimtë (RTD) për OJF nga subjektet raportuese lidhur me dyshime për financim terrorizmi gjatë vitit 2024 ? Nëse po lutem listoni nr. e RAD/RTD sipas subjekteve raportuese? - Nëse keni pasur RAD/RTD gjatë vitit	21.03.2025	Lidhur me pyetjen 1 dhe 2: 1. A ka marrë institucioni juaj Raporte të Aktivitetit të Dyshimtë(RAD)/Raporte të transaksioneve të dyshimtë (RTD) për OJF nga subjektet raportuese lidhur me dyshime për financim terrorizmi gjatë vitit 2024 ? Nëse po lutem listoni nr. e RAD/RTD sipas subjekteve raportuese? 2.Nëse keni pasur RAD/RTD gjatë vitit 2024 për OJF-të cilat janë tipologjitë e tyre? Sa nga këto raste janë dërguara në organet ligj zbatuese? Në lidhje me pikën 1 dhe 2 informojmë se, Agjencia e Inteligjencës Financiare (AIF), gjatë 2024 ka marrë 1(një) RAD me dyshime, nga ana e subjektit raportues bankë, për financim terrorizmi të lidhura me një OJF. Pas analizimit, mbledhjes së të dhënave shtesë etj., rasti është ndarë me struktura me të cilët bashkëpunojmë, në zbatim të legjislacionit në fuqi.	Përfunduar/ dërguar përgjigje me email	Jo

		2024 për OJF-të cilat janë tipologjitë e tyre? Sa nga këto raste janë dërguara në organet ligj zbatuese? - A ka nxjerrë institucioni juaj urdhër bllokimi të përkohshëm për llogari bankare të OJF për rastet e RAD? Nëse po cila është shuma e sekuestruar e llogarisë bankare? - A ka organizuar institucioni juaj takime për të rritur ndërgjegjësimin e OJF mbi PP/FT? Nëse po lutemi të siguroni të dhëna në lidhje me: - Formën e këtyre takimeve; - Numrin e organizatave të njoftuara; - Numrin e organizatave pjesëmarrëse në këto takime.		Lidhur me pyetjen 3: A ka nxjerrë institucioni juaj urdhër bllokimi të përkohshëm për llogari bankare të OJF për rastet e RAD? Nëse po cila është shuma e sekuestruar e llogarisë bankare? Gjatë vitit 2024 nga AIF nuk janë nxjerrë urdhra bllokimi të përkohshëm për ngrirjen e transaksioneve ose të veprimit financiar, të lidhura me OJF. Lidhur me pyetjen 4: A ka organizuar institucioni juaj takime për të rritur ndërgjegjësimin e OJF mbi PP/FT? Nëse po lutemi të siguroni të dhëna në lidhje me: • Formën e këtyre takimeve; • Numrin e organizatave të njoftuara; • Numrin e organizatave pjesëmarrëse në këto takime. Gjatë vitit 2024, AIF në bashkëpunim me sektorin publik dhe atë privat ka përgatitur dhe publikuar “Udhëzues për organizatat jofitimprurëse mbi financimin e terrorizmit” në ndihmë dhe me qëllim ndërgjegjësimin e tyre për rrezikun nga keqpërdorimi/abuzimi i financimit të terrorizmit. Dokumenti ka si qëllim parësor të njohë OJF-të me konceptin e financimit të terrorizmit, njohjen e legjislacionit shqiptar për financimin e terrorizmit, detyrimet ligjore të tyre në kuadër të luftës kundër FT, si mund të ndikojë FT në keqpërdorimin e tyre, metodat e përdorura më shpesh për abuzimin e tyre, mënyra/metodat për vlerësimin e riskut të brendshëm, masa të sugjeruara për parandalimin e keqpërdorimit të tyre si dhe praktikat më të mira ndërkombëtare në këtë fushë. Ky udhëzues është konsultuar me një grup të gjerë të OJF (300 OJF) nëpërmjet dërgimit në adresat e tyre elektronike dhe gjithashtu është	
--	--	--	--	---	--

				vendosur për konsultim publik nëpërmjet publikimit në faqen zyrtare ËEB të AIF. Krijimi i këtij udhëzuesi është mbështetur në praktikat më të mira ndërkombëtare, publikimet e FATF për sektorin e OJF-ve, Vlerësimin Kombëtar të Riskut të Shqipërisë të vitit 2023, tipologjitë e hasura ndër vite nga raportimet e aktiviteteve të dyshimta (RAD), eksperiencia e organeve të zbatimit të ligjit, etj. Dokumentin mund ta gjeni të publikuar në linkun si më poshtë: https://fiu.gov.al/ep-content/uploads/2024/10/Udhezues-OJF.pdf Autoritet mbikëqyrës për OJF në fushën e PPP/FT është Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.		
4.	20.03.2025	Kerkese nga email/qytetar - Sa raste të dyshuara për pastrim parash janë identifikuar nga AIF gjatë vitit të fundit dhe sa prej tyre janë referuar për hetim të mëtejshëm nga autoritetet ligjzbatuese? - Si bashkëpunon AIF me institucionet financiare dhe operatorët privatë për të	28.03.2025	Lidhur me pyetjen 1: Sa raste të dyshuara për pastrim parash janë identifikuar nga AIF gjatë vitit të fundit dhe sa prej tyre janë referuar për hetim të mëtejshëm nga autoritetet ligjzbatuese? Agjencia e Inteligjences Financiare (AIF) shërben si njësi e specializuar financiare për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Kjo agjenci funksionon si qendër kombëtare e ngarkuar me mbledhjen, analizimin dhe shpërndarjen tek agjencitë e zbatimit të ligjit të të dhënave për veprimtaritë e mundshme të pastrimit të parave të financimit të terrorizmit. Për vitin 2024^[1] informojmë se në zbatim të detyrimeve ligjore që kanë subjektet raportuese për ligjin nr. 9917 datë 19.05.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit” i	Përfunduar/ dërguar përgjigje me email	Jo.

^[1] Raporti vjetor 2024 pritet të publikohet së shpejti.

		identifikuar transaksionet e dyshimta dhe për të garantuar që bankat nuk bëhen kanal për pastrimin e parave?	ndryshuar^[2], janë dërguar 1,632 Raportime të Aktivitetit të Dyshimtë (RAD). Subjektet e ligjit (banka, noter, shoqëri transfertash etj) dërgojnë raporte për aktivitet të dyshimtë pranë AIF, të cilat trajtohen/analizohen bazuar në të dhënat që disponohen (raportime, akseset në regjistra) apo sigurohen në bazë të kërkesave të mëtejshme (ku përfshihen kërkesa për subjektet e ligjit apo organe publike, kërkesa për homologët tanë etj.) dhe në rast se konstatohen dyshime, dërgohen për ndjekje të mëtejshme në institucionet ligj zbatuese (Policinë e Shtetit apo Prokurori) apo të inteligjencës. Gjatë vitit 2024 rezultoi se janë shpërndarë nga AIF në organet ligjzbatuese (Policinë e Shtetit dhe Prokuroritë) 234 raste për investigim të mëtejshëm. Lidhur me pyetjen 2: Si bashkëpunon AIF me institucionet financiare dhe operatorët privatë për të identifikuar transaksionet e dyshimta dhe për të garantuar që bankat nuk bëhen kanal për pastrimin e parave? AIF publikon në faqen e saj zyrtare çdo vit, Raportin Vjetor në të cilën pasqyrohet puna e kryer përgjatë një viti. Në këto raporte në mënyrë të detajuar parashtrihen të dhëna në lidhje me analizimin, dërgimin i informacionit në organet e zbatimit të ligjit, tipologji, tregues, analizimi i përputhshmërisë së subjekteve raportuese, inspektimet në vend, në distancë, bashkëpunimin kombëtar ndër-institucional, bashkëpunimin me Njësitë e Inteligjencës Financiare ndërkombëtare etj. Për më shumë informacion, referohuni në Raportin Vjetor të publikuar nga AIF, në linkun:		
--	--	--	--	--	--

^[2] <https://fiu.gov.al/legislacioni/ligje/>

				https://fiu.gov.al/ep-content/uploads/2024/06/Raporti-Vjetor-2023.pdf , faqe me interes 21-23.		
5.	03.04.2025	Kerkese per informacion nga email/ shoqate Ju drejtohem për të kërkuar informacion zyrtar lidhur me monitorimin e trafikut të komunikimeve elektronike, përdorimin e teknologjisë DPI (Deep Packet Inspection) dhe ndërhyrjet në lirinë e aksesit në rrjetin social TikTok për qytetarët shqiptarë. Në veçanti, kërkojmë sqarime mbi bazën ligjore, procedurat dhe institucionet përgjegjëse për këto masa, si dhe transparencën e ndjekur në marrjen e tyre. Duke marrë parasysh rëndësinë e çështjes dhe ndikimin e saj në të drejtat digjitale, ju lutemi të na vini në dispozicion informacionin e kërkuar	09.04.2025	Në përgjigje të kërkesës tuaj per informacion, ku kërkonti “Informacion zyrtar mbi monitorimin e trafikut të komunikimeve elektronike, përdorimin e teknologjisë DPI dhe procedurat e ndjekura për kufizimin e aksesit në rrjetin social TikTok në Shqipëri”, dëshirojmë t’ju informojmë se: Agjencia e Inteligjencës Financiare, në cilësinë e Autoritetit Përgjegjës, shërben si njësi e specializuar financiare për parandalimin dhe luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Gjithashtu, kjo drejtori funksionon si qendër kombëtare e ngarkuar me mbledhjen, analizimindhe shpërndarjen tek agjencitë e zbatimit të ligjit të të dhënave për veprimtaritë e mundshme të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Në asnjë nga funksionet dhe detyrat e saj funksionale, Agjencia e Inteligjencës Financiare nuk ka përgjegjësi monitorimin e trafikut të komunikimeveelektronike. Në këtë kuadër dëshirojmë t’ju informojmë se Agjencia e Inteligjencës Financiare nuk disponon asnjë informacion zyrtar lidhur me përdorimin e teknologjisë DPI (Deep Packet Inspection) dhe ndërhyrjen në rrjetin social TikTok për qytetarët Shqiptarë.	Përfunduar/ dërguar përgjigje me email dhe shkrese	Jo

		brenda afateve të parashikuara ligjërisht.				
6.	10.04.2025	Kerkese nga email/gazetar Ne redaksine tone ka mberritur nje shqetesim nga nje qytetare Shqetesimi i ngritur lidhet me faktin se qytetari i cili me heret ka qenë ne nje proces penal, tani eshte i lire dhe kerkon te ushtroje nje aktivitet fitimprures privat. Qytetari ankohet se po has probleme ne Bankat e Nivelit te Dyte per te hapur nje llogari bankare biznesi. Pyetjet qe une ngre dhe nes emund te marr pergjigje nga ju jane: A ka ndonje dispozite ligjore ne Shqiperi e cila sanksionon ndalimin e te drejtes per te marre sherbime ne sektorin bankar te personave me precedent te kaluar penal?	18.04.2025	Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, sipas email të mëposhtëm dhe informacionit të vënë në dispozicion, ju informojmë se, Agjencia e Inteligjencës Financiare (AIF), vepron në zbatim të ligjit nr. 9917 datë 19.05.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit” i ndryshuar dhe shërben si njësi e specializuar financiare për parandalimin dhe luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Ne vijim te sa me sipër AIF nuk ka në kompetencë të saj përcaktimin e politikave të brendshme të sektorit bankar duke përfshirë politikat e vendosjes së marrëdhënies së biznesit me klientë. Çdo subjekt financiar ashtu si edhe bankat janë përgjegjëse për vendosjen e marrëdhënies së biznesit në zbatim të politikave të tyre të brendshme si dhe në zbatim të legjislacionit në fuqi të cilat sektori bankar i nënshtrohet.	Përfunduar/ dërguar përgjigje me email	Jo.

		Cila mund te jete zgjidhja nese Bankat e nivelit te dyte nuk japin akses? Ne kete menyre, a stimulojne bankat perdorimin e parase cash, pra jashte sistemit te gjurmueshem? A stimulojne ne kete menyre pastrimin e parave?				
7.	12.05.2025	Kërkesë me shkresë/qytetar Institucioni X, me ka njoftuar, per refuzimin e kërkesës per licencim ose miratim si subjekt financiar. Kerkoj informacion nëse ndaj personit tim është përpunuar, ruajtur apo transmetuar ndonjë informacion që lidhet me figurën tuaj morale, penale, profesionale apo financiare dhe që mund të ketë ndikuar në procesin e licencimit.	14.05.2025	Jemi njohur me kërkesën Tuaj, me anë të së cilës kërkonti informacion nëse ndaj personit Tuaj është përpunuar, ruajtur apo transmetuar ndonjë informacion që lidhet me figurën tuaj morale, penale, profesionale apo financiare dhe që mund të ketë ndikuar në procesin e licencimit. Në lidhje me sa kërkonti, Ju vëmë në dijeni, se bazuar në nenin 21 pika 2 dhe nenin 22 shkronja (a) dhe (e) të Ligjit nr. 9917/2018 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit” (i ndryshuar), Agjencia e Inteligjencës Financiare (AIF) shkëmben informacion për çështjet e pastrimit të produkteve të veprës penale, veprat penale ose veprimtaritë kriminale që gjenerojnë produkte të veprës penale apo financimit të terrorizmit vetëm me autoritetet kompetente të zbatimit të ligjit apo të inteligjencës. Gjithashtu, bazuar në nenin 22/1 të ligjit 9917/2008, i ndryshuar, çdo informacion apo e dhënë, e dërguar nga AIF për organet e zbatimit të ligjit, i nënshtrohet ligjit për informacionin e klasifikuar sekret shtetëror.	Përfunduar/ dërguar përgjigje me shkrese	Jo.

8.	12.05.2025	Kërkesë me shkresë/qytetar (kerkese e njejte si me sipër por me kërkuar tjetër)	14.05.2025	Jemi njohur me kërkesën Tuaj, me anë të së cilës kërkonti informacion nëse ndaj personit Tuaj është përpunuar, ruajtur apo transmetuar ndonjë informacion që lidhet me figurën tuaj morale, penale, profesionale apo financiare dhe që mund të ketë ndikuar në procesin e licencimit. Në lidhje me sa kërkonti, Ju vëmë në dijeni, se bazuar në nenin 21 pika 2 dhe nenin 22 shkronja (a) dhe (e) të Ligjit nr. 9917/2018 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit” (i ndryshuar), Agjencia e Inteligjencës Financiare (AIF) shkëmben informacion për çështjet e pastrimit të produkteve të veprës penale, veprat penale ose veprimtaritë kriminale që gjenerojnë produkte të veprës penale apo financimit të terrorizmit vetëm me autoritetet kompetente të zbatimit të ligjit apo të inteligjencës. Gjithashtu, bazuar në nenin 22/1 të ligjit 9917/2008, i ndryshuar, çdo informacion apo e dhënë, e dërguar nga AIF për organet e zbatimit të ligjit, i nënshtrohet ligjit për informacionin e klasifikuar sekret shtetëror.	Përfunduar/ dërguar përgjigje me shkrese	Jo.
9.	30.05.2025	Kërkesë me shkresë/qytetar Kërkojmë të na vini në dispozicion një kopje të vendimit të institucionit x, për heqjen e “Certifikatës së sigurisë së personelit”	05.06.2025	Në përgjigje të kërkesës tuaj protokolluar në Agjencinë e Inteligjencës Financiare, ju informojmë se me shkresën “Njoftim” jeni informuar se institucioni x bazuar në nenin 27 pika 2 të Ligjit 10/2023 “Për informacionin e klasifikuar” dhe nenin 27 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 731, datë 27.11.2024, ka njoftuar se ka marrë vendim për heqjen e “Certifikatës së sigurisë së personelit”.	përfunduar/ dërguar përgjigje me shkrese	Jo
10.	30.06.2025	Kërkesë me email/gazetar A keni pasur ju si institucion raportime për "Pastrim Parash" ne sektorin e ndërtimit për vitin 2024-2025? Sa raste kanë qenë? Kane qene raportime për individë, pra për raste për	03.07.2025	Lidhur me pyetjen 1: A keni pasur ju si institucion raportime për "Pastrim Parash" ne sektorin e ndërtimit për vitin 2024-2025? Sa raste kanë qenë? Në bazë të të dhënave të disponuara për periudhën e kërkuar rezultojnë Raportime të Aktiviteteve të Dyshimta (RAD) nga subjektet e ligjit, të dërguara në pjesën më të madhe nga bankat por dhe nga noter, kryesisht për dyshime të lidhura me investime në vlera të larta në pasuri të paluajtshme nga individë (<i>me fonde të pajustificuara nga burime të ligjshme</i>) dhe pak raste me dyshime sporadike për shoqëri ndërtimi.	përfunduar/ dërguar përgjigje me email	Jo

		blerje e një banese apo nga subjekte ndërtuese (Kompani)? Çfarë procedurash janë ndjekur nëse ka pasur raste?		Dyshimet kryesore për këtë sektor janë: - Investime në pasuri të paluajtshme me burim të panjohur fondesh; - Depozitime cash dhe investim në pasuri të paluajtshme nga persona të përfshirë në aktivitete të paligjshme; - Blerje pasuri të paluajtshme me anomali në çmim (blerë nën vlerën e tregut); - Investime në pasuri të paluajtshme në vende me risk (jashtë territorit të Shqipërisë); - Investime në vlera të konsiderueshme nga individë dhe subjekte tregtare në zona turistike. Lidhur me pyetjen 2: Kane qene raportime për individë, pra për raste për blerje e një banese apo nga subjekte ndërtuese (Kompani)? Në pjesën më të madhe RAD për këtë sektor kanë qenë kryesisht për investime të kryera nga individ por ka edhe nga subjekte tregtare. Lidhur me pyetjen 3: Çfarë procedurash janë ndjekur nëse ka pasur raste? RAD e raportuara nga subjektet e ligjit, në tërësi i nënshtrohen një analize të detajuar, duke përfshirë dhe të dhëna të tjera nga sisteme që disponojmë apo të siguruara me kërkesa sipas rastit. Për ato raste të konkluduara me dyshime për pastrim parash, dërgohen nga AIF në organet ligj zbatuese për ndjekje të mëtejshme. Gjatë vitit 2024 – deri në Maj 2025, për dyshime në sektorin e pasurive të paluajtshme, janë dërguar rreth 70 informacione në organet ligj zbatuese.		
11.	07.07.2025	Kerkese me email/ organizate 1. Cila është koha mesatare që i duhet Agjencisë së Inteligjencë Financiare për të gjurmuar transaksionet e kriptomonedhave të lidhura	10.07.2025	Lidhur me pyetjen 1: Cila është koha mesatare që i duhet Agjencisë së Inteligjencë Financiare për të gjurmuar transaksionet e kriptomonedhave të lidhura me aktivitet të dyshuar kriminal? Agjencia e Inteligjencës Financiare (AIF) për trajtimin e rasteve të cilat përfshijnë mjetet virtuale ka në zotërim 2 programe (TRM Labs dhe	përfunduar/ dërguar përgjigje me email	Jo

	me aktivitet të dyshuar kriminal? 2. Çfarë numri dhe përqindje e raporteve të transaksioneve të dyshimta (STR) në vitet 2020, 2021, 2022, 2023, 2024 dhe nga 1 janari deri më 30 qershor 2025 në lidhje me kriptomonedhat kanë çuar në shpërndarjen/referimin e raporteve të inteligjencës tek institucionet përkatëse? 3. Sa inspektive mbikëqyrëse ose vlerësime të përputhshmërisë së VASP-ve janë kryer në vitet 2020, 2021, 2022, 2023, 2024 dhe nga 1 janari deri më 30 qershor 2025, dhe cilat ishin gjetjet ose dështimet më të zakonshme të përputhshmërisë të identifikuara gjatë këtyre inspektimeve? 4. Sa STR u dërguan nga VASP-të në vitet 2020, 2021, 2022, 2023, 2024 dhe	Chaialysis) të cilat përdoren edhe nga agjencitë ligjzbatuese vendase dhe të huaja për gjurmimin/hetimin e tyre. Gjithashtu përdoren edhe Blockchain (Blockchain.com, Etherscan.io, Tronscan.org, Bnbscan.com Blockchain.com, Opensea.com, etj.) nga burime të hapura në varësi të monedhës/token që është i përfshirë. AIF bashkëpunon edhe me njësitë homologe të inteligjencës jashtë vendit nëse ka indicie për përfshirje në pastrim parash apo financim terrorizmi. Lidhur me pyetjen 2: Çfarë numri dhe përqindje e raporteve të transaksioneve të dyshimta (STR) në vitet 2020, 2021, 2022, 2023, 2024 dhe nga 1 janari deri më 30 qershor 2025 në lidhje me kriptomonedhat kanë çuar në shpërndarjen/referimin e raporteve të inteligjencës tek institucionet përkatëse? Duke qenë se deri më tani në Shqipëri nuk ka asnjë VASP të licencuar, nuk ka pasur as Raporte të Aktivitetit të Dyshimtë (RAD) të raportuara nga kjo kategori. Kemi pasur raste sporadike të individëve të cilët kanë investuar në mjete virtuale apo kanë përfituar nga investimet e kryer jashtë vendit. Lidhur me pyetjen 3: Sa inspektive mbikëqyrëse ose vlerësime të përputhshmërisë së VASP-ve janë kryer në vitet 2020, 2021, 2022, 2023, 2024 dhe nga 1 janari deri më 30 qershor 2025, dhe cilat ishin gjetjet ose dështimet më të zakonshme të përputhshmërisë të identifikuara gjatë këtyre inspektimeve? Deri më tani nuk ka asnjë VASP të licencuar pranë Autoriteti të Mbikëqyrjes Financiare, si rrjedhojë as inspektive. Lidhur me pyetjen 4: Sa STR u dërguan nga VASP-të në vitet 2020, 2021, 2022, 2023, 2024 dhe nga 1 janari deri më 30 qershor 2025, dhe cili ka qenë ndikimi i tyre në analizën dhe shpërndarjen e raporteve tek institucionet përkatëse?		
--	--	--	--	--

		nga 1 janari deri më 30 qershor 2025, dhe cili ka qenë ndikimi i tyre në analizën dhe shpërndarjen e raporteve tek institucionet përkatëse?		Deri më tani nuk ka asnjë VASP të licencuar, për rrjedhojë as RAD prej tyre.		
Gusht 2025-Nuk ka kërkesa per informacion						
Shtator 2025-Nuk ka kërkesa per informacion						
12	10.10.2025	Kërkesë për informacion/organizatë 1. Numri i raporteve për transaksione të dyshimta (STR) dhe aktivitete të dyshimta (SAR) të lidhura me kontrabandën e emigrantëve për periudhën 2021–2025, sipas vitit dhe subjekteve raportuese. 2. Vlera e fondeve të ngrira në transaksione të dyshimta për pastrim parash që lidhen me kontrabandën e emigrantëve për	21.10.2025	Në lidhje me pyetjen 1: Numri i raporteve për transaksione të dyshimta (STR) dhe aktivitete të dyshimta (SAR) të lidhura me kontrabandën e emigrantëve për periudhën 2021–2025, sipas vitit dhe subjekteve raportuese. Në funksion të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në zbatim të ligjit nr. 9917 datë 19.05.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit” i ndryshuar., parashikon një sërë subjektesh si bankat, shoqëritë e transfertave, noterë, shoqëri ndërtimi, zyrat e këmbimeve valutore, etj. të cilët kanë detyrime për marrje masash për identifikimin e klientëve të tyre /klientëve potencialë e më tej monitorimin, sigurimin, mbajtjen e të dhënave për burimin e fondeve, të përcaktimit të risqeve brenda subjektit, të trajnimit të punonjësve të tyre, implementimin e sanksioneve ndërkombëtare për personat e shpallur, të raportimit pranë AIF të aktiviteteve të dyshimta (RAD) etj. Një nga detyrat më të rëndësishme të AIF është mbledhja, analizimi dhe shpërndarja e rasteve të dyshimta për organet e zbatimit të ligjit dhe ato të inteligjencës. Në rastet kur nga subjektet e ligjit sinjalizohet	përfunduar/ dërguar përgjigje me email	Jo

		periudhën 2021–2025, sipas vitit dhe vlerës. 3. Numri i shkëmbimeve të informacionit me partnerë ndërkombëtarë në raste të dyshuara për pastrim parash të lidhura me kontrabandën e emigrantëve për periudhën 2021–2025, sipas vitit.		një rast i dyshimtë, rastet trajtohen/analizohen nga ana jonë, bazuar në të dhënat që disponohen apo sigurohen në bazë të kërkesave të mëtejshme dhe në rast se konstatohen dyshime, dërgohen për ndjekje të mëtejshme në institucionet ligj zbatuese apo të inteligjencës. Gjatë analizës së rasteve të dërguara nga AIF në agjencitë ligjzbatuese, kur është e mundur apo ka të dhëna, identifikohet vepra penale origjinuese e dyshuar apo lidhje të mundshme kriminale të personave dhe subjekteve (identifikimi i veprës mëmë është në nivel dyshimi/indicie nisur nga informacioni që disponojmë, pra jo e provuar). Kështu gjatë periudhës 2021- Shtator 2025 nga ana e AIF janë dërguar në organet ligj zbatuese 23 raste me dyshime të lidhura me “Ndihmë për kalim të paligjshëm të kufirit ose emigracion i paligjshëm” të detajuara si më poshtë. Vlerat e transaksioneve të dyshimta të evidentuara në rastet e shpërndara nga AIF me këto dyshime janë relativisht të ulëta (variojnë nga 100 euro në 2000 euro). Për këto raste të dërguara nga AIF në organet ligjzbatuese, raportet e aktivitet të dyshimtë (RAD) janë dërguar nga shoqëritë e trasnfertave që operojnë në vend, të cilat kanë identifikuar lëvizje të dyshimta të fondeve që mund të lidhen me veprimtari të paligjshme. <table><tr><th>Viti</th><th>2021</th><th>2022</th><th>2023</th><th>2024</th><th>Janar-Shtator 2025</th></tr><tr><td>Nr i rasteve të shpërndara në organet ligjzbatuese, me vepër mëmë: Ndihmë për kalim të paligjshëm të</td><td>0</td><td>8</td><td>3</td><td>11</td><td>1</td></tr></table>	Viti	2021	2022	2023	2024	Janar-Shtator 2025	Nr i rasteve të shpërndara në organet ligjzbatuese, me vepër mëmë: Ndihmë për kalim të paligjshëm të	0	8	3	11	1		
Viti	2021	2022	2023	2024	Janar-Shtator 2025													
Nr i rasteve të shpërndara në organet ligjzbatuese, me vepër mëmë: Ndihmë për kalim të paligjshëm të	0	8	3	11	1													

				kufirit ose emigracion i paligjshëm		
				Në lidhje me pyetjen 2: Vlera e fondeve të ngrira në transaksione të dyshimta për pastrim parash që lidhen me kontrabandën e emigrantëve për periudhën 2021–2025, sipas vitit dhe vlerës. Informojmë se AIF, nuk ka nxjerë nga urdhra bllokimi për transaksione të dyshimta për pastrim parash që lidhen me veprimtari të paligjshme “Ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve, emigracion i paligjshëm”; Në lidhje me pyetjen 3: Numri i shkëmbimeve të informacionit me partnerë ndërkombëtarë në raste të dyshuara për pastrim parash të lidhura me kontrabandën e emigrantëve për periudhën 2021–2025, sipas vitit. Në lidhje kërkesa të dërguara dhe të marra nga homologët, informojmë se për periudhën 2023 –shtator 2025 janë dërguar 2 kërkesa^[1] nga AIF dhe kemi marrë 9 kërkesa^[2] nga homologët. Për periudhën 2021-2022 mënyra e mbajtjes së të dhënave nuk e mundëson ndarjen sipas veprës penale të dyshuar.		
13	16.10.2025	Kërkesë për informacion/organizatë 1. A mund te konfirmoni qe per periudhen 2021-2025 kontabilistet nuk	20.10.2025	Në përgjigje të kërkesës suaj, ju lutemi të gjeni më poshtë sqarimet përkatëse lidhur me pyetjet e parashtruara, konkretisht: Sipas Raportit Vjetor për vitin 2024, statistikat mbi subjektet që kanë dërguar Raporte për Aktivitet të Dyshimtë janë paraqitur në tabelën më poshtë, siç figurojnë në raportin e publikuar në faqen e internet https://fiu.gov.al/lista-e-publikimeve/raporte/ , në faqen 6.	përfunduar/ dërguar përgjigje me email	Jo

^[1] Të vitit 2025

^[2] 6 në 2023 dhe 3 në 2024.

kane derguar asnje RAD?

2. Pervec numrit te RAD nga biznet dhe profesionet jo-financiare te cilat jane te paraqitura ne rapore vjetore, a keni te dhena rreth vleres totale te RAD per secilen subjekt raportues per periudhen 2021-2024? Nese po, a mund te na dergoni keto te dhena vetem per bizneset dhe profesionet jo-financiare?

Tabela 1: RAD të raportuara, sipas kategorisë së subjekteve për periudhën 2020 – 2024.

Subjekti raportues	2020	2021	2022	2023	2024
Banka	703	725	660	756	718
Shoqëri transfertash	315	290	293	323	365
DPD	44	33	25	24	8
DPT	10	6	9	8	4
ASHK	0	16	22	29	33
Noter	321	482	735	516	413
ZKV	4	4	9	32	19
Inst. financiare të mikro-kredisë	9	17	28	21	16
Shoqëri të qiradhënies financiare	0	1	0	5	6
Shoqëri ndërtimi	2	2	0	1	0
Shoqëri tregtimi mjetesh motorike	0	0	3	3	8
Shoqëri pagesash elektronike	0	0	1	1	26
Avokat	0	1	0	0	0
Ndërmjetës të Pasurive të Paluajtshme	0	0	0	1	5
Shoqëri transporti	1	0	0	0	0
Fond investimi	0	0	0	1	0
Shoqëri pagesash	0	3	5	7	9
Lojëra Fati	0	0	0	0	2
Tjetër	0	1	0	0	0
Total	1,409	1,581	1,790	1,728	1,632

Për vitin 2025 për periudhën Janar-Shtator 2025, te dhënat për RAD e raportuara nga subjektet janë si më poshtë vijon:

Subjekti raportues	Janar – Shtator 2025
Banka	548
Shoqëri transfertash	199
DPD	8
DPT	2
ASHK	8
Noter	324
ZKV	61
Inst. financiare të mikro-kredisë	20

				<table><tr><td>Shoqëri të qiradhënies financiare</td><td>2</td></tr><tr><td>Shoqëri ndërtimi</td><td>-</td></tr><tr><td>Shoqëri tregtimi mjetesh motorike</td><td>3</td></tr><tr><td>Shoqëri pagesash elektronike</td><td>15</td></tr><tr><td>Avokat</td><td>-</td></tr><tr><td>Ndërmjetës të Pasurive të Paluajtshme</td><td>5</td></tr><tr><td>Shoqëri transporti</td><td>-</td></tr><tr><td>Fond investimi</td><td>-</td></tr><tr><td>Shoqëri pagesash</td><td>-</td></tr><tr><td>Lojëra Fati</td><td>2</td></tr><tr><td>Tjetër</td><td>2</td></tr><tr><td>Total</td><td>1199</td></tr></table>	Shoqëri të qiradhënies financiare	2	Shoqëri ndërtimi	-	Shoqëri tregtimi mjetesh motorike	3	Shoqëri pagesash elektronike	15	Avokat	-	Ndërmjetës të Pasurive të Paluajtshme	5	Shoqëri transporti	-	Fond investimi	-	Shoqëri pagesash	-	Lojëra Fati	2	Tjetër	2	Total	1199		
Shoqëri të qiradhënies financiare	2																													
Shoqëri ndërtimi	-																													
Shoqëri tregtimi mjetesh motorike	3																													
Shoqëri pagesash elektronike	15																													
Avokat	-																													
Ndërmjetës të Pasurive të Paluajtshme	5																													
Shoqëri transporti	-																													
Fond investimi	-																													
Shoqëri pagesash	-																													
Lojëra Fati	2																													
Tjetër	2																													
Total	1199																													
Shënim: Statistikat janë të pa konsoliduara dhe mund të përmbajnë ndonjë pasaktësi të vogël. Nuk rezultojnë RAD të raportuara nga Kontabilistë për periudhën 2021-2025. Lidhur me pyetjen e dytë, të dhënat për numrat janë si më sipër, ndërsa vlera totale për secilën kategori nuk mund të nxirret, për shkak të mënyrës së raportimit të të dhënave, formateve përkatëse sipas llojeve të subjekteve, si edhe përfshirjes së shumave në qeliza të veçanta apo në përshkrime të ndryshme. Gjejmë rastin t’ju informojmë edhe për dy dokumente të rëndësishme të miratuara në vitet 2024–2025: ➤ Strategjia Kombëtare për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit 2024–2030 Strategjia Kombëtare 2024–2030, e miratuar nga Komiteti i Bashkërendimit të Luftës kundër Pastrimit të Parave, është dokumenti që përcakton politikat shtetërore për forcimin e regjimit kombëtar kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Ajo mbështetet në një analizë të thelluar të riskut në nivel vendi, vlerësimeve të MONEYVAL dhe standardeve të FATF, duke synuar ndërtimin e një sistemi më efektiv, të koordinuar dhe të qëndrueshëm institucionalisht.																														

				Strategjia përfshin gjashtë objektiva kryesorë: përmirësimin e kuadrit rregullator dhe koordinimit ndërinstytucional; rritjen e efektivitetit të sistemit parandalues; forcimin e kapaciteteve operacionale të organeve ligjzbatuese; shfrytëzimin e inovacioneve teknologjike; rritjen e efikasitetit mbikëqyrës; dhe zgjerimin e bashkëpunimit ndërkombëtar. Dokumenti shoqërohet me një plan të detajuar veprimi dhe përbën bazën e politikave të ardhshme të qeverisë shqiptare në fushën e PP/FT. Zbatimi i këtij plani veprimi monitorohet mbi baza 4 mujore. AIF në këtë proces ka rolin e sekretariatit teknik, i dërgon institucioneve përgjegjëse shkresat zyrtare për raportim dhe koordinon kthim përgjigjet e tyre. Monitorimi i strategjisë raportohet në mbledhjet e GTNP (Grupit Teknik Ndërinstitucional të Punës) gjatë mbledhjeve periodike që ky grup mban. ➤ Strategjia për Edukimin e Publikut mbi Rreziqet e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit 2025–2027 Strategjia e edukimit publik 2025–2027, e miratuar nga Grupi Teknik Ndërinstitucional i Punës, është dokumenti plotësues që synon të rrisë ndërgjegjësimin e publikut, bizneseve dhe institucioneve për pasojat ekonomike, shoqërore dhe të sigurisë që sjellin pastrimi i parave dhe financimi i terrorizmit. Ajo përqendrohet në komunikim të gjerë përmes kanaleve zyrtare të Agjencisë së Inteligjencës Financiare, trajnimeve, udhëzuesve dhe aktiviteteve publike. Strategjia synon të edukojë qytetarët dhe grupet me risk për të njohur treguesit e veprimtarive të dyshimta, duke e lidhur drejtpërdrejt me prioritetet e Strategjisë Kombëtare 2024–2030 për forcimin e politikëbërjes, efektivitetit operacional dhe përdorimin e teknologjive të reja në luftën kundër PP/FT. Duke qenë se kjo strategji është pjesë e zbatimit të planit të masave të veprimit të Strategjisë Kombëtare për PPP/FT edhe zbatimi i saj monitorohet çdo 4 muaj nga AIF, në rolin e sekretariatit teknik.		
--	--	--	--	---	--	--

14	09.10.2025	Kërkesë për informacion me shkresë -qytetar Kërkesë për deklasifikimin e shkresës nr. xx datë xxx	20.10.2025	Klasifikimi i shkresës nr.xx prot., datë xx nga ana e DPPP është realizuar në përputhje me parashikimet ligjore, duke u shpjeguar si më poshtë: Ligji Nr.9917, datë 19.5.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit” i ndryshuar, i cili përben kornizën kryesore të veprimtarisë së AIF si dhe është ligj i posaçëm, parashikon: • neni 21 pika 1, AIF “<i>brenda fushës së veprimtarisë së vet ka të drejtë të vendosë për mënyrën e ndjekjes dhe të zgjidhjes së çështjeve të trajtuara për pastrimin e mundshëm të parave (..)</i>” • neni 22 germa “e”, AIF “<i>shkëmben informacion me prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm, Prokurorinë e Posaçme, Policinë e Shtetit, Byronë Kombëtare të Hetimit, Shërbimin Informativ të Shtetit dhe autoritetet e tjera kompetente të zbatimit të ligjit apo të inteligjencës, për çështjet e pastrimit të produkteve të veprës penale, veprat penale ose veprimtaritë kriminale që gjenerojnë produkte të veprës penale, financimit të terrorizmit, si dhe mund të nënshkruajë marrëveshje bashkëpunimi dy ose shumëpalëshe më to</i>”; • neni 22/1 paragrafi i parë “<i>Çdo informacion apo e dhënë, e dërguar nga Agjencia e Inteligjencës Financiare për organet e zbatimit të ligjit, i nënshtrohet ligjit për informacionin e klasifikuar sekret shtetëror dhe nuk përbën provë në kuptimin e Kodit të Procedurës Penale.</i>” Pra nga sa më sipër, AIF (ish DPPP) i ka të përcaktuara organet me të cilat shkëmben informacion, nuk është e autorizuar për të kryer shkëmbime përtej këtyre organeve, si dhe klasifikimi parashikohet për të gjitha informacionet e dërguara.	përfunduar/ dërguar përgjigje me shkresë	Jo
----	------------	---	------------	---	---	----

				Përveç parashikimeve në ligj si më sipër, DPPP (AIF) ka pasur detyrimin për klasifikimin e shkresave në përputhje me Urdhrin e Ministrit të Financave. Klasifikimi i korrespondencës është e mbështetur në dispozita të ligjit të posaçëm, si dhe akte nënligjore përkatëse, të shpjeguara më sipër. Ligji Nr.9917, datë 19.5.2008 <i>“Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”</i>, në neni 21 pika 1/1 parashikon se, <i>“Në funksion të ruajtjes së konfidencialitetit për fushën e veprimtarisë së vet, sigurisë së personelit apo sistemeve në përdorim, Agjencia e Inteligjencës Financiare mund të vendosë kufizime për të dhënat e kërkuara në funksion të së drejtës për informim, nëse kufizimi është i domosdoshëm dhe proporcional (...)”</i> E drejta për t’u informuar është e garantuar me ligjin nr. 119/2014 <i>“Për të drejtën e informimit”</i>, por ky ligj, në nenin 17, • përcakton kufizime, në rase se dhënia e informacionit shkakton ndaj interesave për parandalimin, hetimin dhe ndjekjen e veprave penale, si dhe sigurinë kombëtare, sipas përkufizimit të bërë nga legjislacioni për informacionin e klasifikuar; • kufizohet edhe në rastet kur dhënia e informacionit dëmton të drejtën për një jetë private. Pretendimet e thelbit të çështjes të parashtruar në vitin 2019 janë të një natyre e cila kërkon shqyrtim gjyqësor për të përcaktuar nëse është civile apo penale, ndërsa pretendimet e mundshme lidhje me hetimin e kryer nga Prokurori, lutemi ti adresoni në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi në fushën penale, procedurë në të cilën AIF nuk ka kompetenca.		
--	--	--	--	---	--	--

			AIF ka detyrimin ligjor dhe institucional për të administruar informacionin në përputhje me legjislacionin në fuqi, si dhe mbrojtjen e të dhënave konfidenciale që lidhen më veprimtarinë e saj. Në këtë kuadër, çdo veprim apo vendim lidhur më trajtimin, ruajtjen, klasifikimin apo deklasifikimin e dokumenteve të tilla është kryer në përputhje me legjislacionin e kohës në fuqi, por është në përputhje edhe më legjislacionin aktual, konkretisht ligjin nr. 10/2023 “<i>Për informacionin e klasifikuar</i>”. Marrë në konsideratë shpjegimet e dhëna në shkresë dhe kriteret e mësipërme, nuk rezultojnë kushtet për deklasifikim të shkresës Nr. xx date xx. Nga sa më sipër, jemi në kushtet kur klasifikimi ka ndodhur për shkak të bazës ligjore. Nëse marrim në konsideratë Neni 40 (Kriteret për deklasifikim) të V.K.M nr. 822, datë 26.12.2024, rezulton se parashikohet si më poshtë <i>“1. Deklasifikimi i informacionit të klasifikuar është në dy lloje:</i> <i>a) “Deklasifikim i plotë”, procesi i ndryshimit të autorizuar të statusit të një informacioni të klasifikuar “Sekret shtetëror” në një informacion të paklasifikuar;</i> <i>b) “Deklasifikim i pjesshëm”, procesi i ndryshimit të autorizuar të statusit të një pjese të informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror” në informacion të paklasifikuar.</i> <i>2. Informacioni mund të deklasifikohet:</i> <i>a) me ndodhinë e një ngjarjeje apo të një date të veçantë, siç përcaktohet nga autoriteti i klasifikimit të informacionit;</i> <i>b) me përfundimin e afatit kohor për klasifikim;</i> <i>c) kur publikimi i tij diktohet nga interesa më të rëndësishme shtetërore, sesa nevoja për ta mbajtur atë të klasifikuar;</i> <i>ç) me kërkesë të gjykatës, kur informacioni i klasifikuar është sekuestruar nga organi procedues në përputhje me Kodin e Procedurës Penale.</i>	
--	--	--	--	--

				<i>3. Informacioni i klasifikuar nuk deklasifikohet si rezultat i ekspozimit të paautorizuar të një informacioni identik apo të ngjashëm.”</i> Marrë në konsideratë shpjegimet e dhëna nuk rezultojnë kushtet për deklasifikim të shkresës xx.		
--	--	--	--	--	--	--